

VENDI M
Nr. 637, datë 5.11.2025

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA
MINISTRIA E DREJTËSISË TEK KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, PËR
GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TË PRONËS,
ME EMËRTIMIN “GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM”, ME NUMËR PASURIE 6/523 DHE PJESË TË PASURISË ME
NUMËR 6/210, NË ZONËN KADASTRALE 8150, TIRANË, SI DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1292, DATË 24.9.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË DREJTËSISË SË TROJEVE DHE NDËRTESAVE TË
GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË GJYKATAVE TË APELIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë tek Këshilli i Lartë Gjyqësor, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të pronës, me emërtimin “Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, me numër pasurie 6/523 dhe pjesë të pasurisë me numër 6/210, në zonën kadastrale 8150, Tiranë, me qëllim për t’u përdorur për ushtrimin e aktivitetit administrativ, sipas formularit, 1 (një) fletë, dhe planrilevimit, 1 (një) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Prona me emërtimin “Ish-Gjykata e Apelit Ushtarak, Tiranë” hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë së trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit”, të ndryshuar.

3. Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, tjetërsimi ose dhënia në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

E SHTETERORE

(Signature)

(Circular Stamp: QYKATAR, SHQIPËRI, REPUBLIKË E SHQIPËRISË)

Identifikoi: Anjeza Bani ; Drejtor Drejtorie
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Lertida Balili, Kancelar
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Iliba Bezati , Zëvendëskryetar
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

[illegible]

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : SHTET

DATE : 28/07/2025

QELLIMI : INVENTARIZIM / REGJISTRIM

VENDNDODHJA

BASHKIA TIRANE DVASHK/ZVASHK TIRANE VERI

ZONA KADASTRALE 8150

NUMRI PASURISE 6/210 DHE 6/523

INDEX HARTE TR; P-13

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE : TRUALL, RRUGE

SIP.PAS. 6/523 S= 368.14 m2

SIP.PAS. 6/210 S= 1421.5 m2

SIPERFAQE E GJURMES SE NDERTIMIT = 245.87m2

SIPERFAQE E GJURMES SE NDERTIMIT = m2

NUMRI KATEVE

NUMRI PEMEVE


X=485418.8135

Y=4576897.3787

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=485418.8135

Y=4576962.0616



X=485516.1829
Y=4576897.3787

SH 1:500

X=485516.1829
Y=4576962.0616

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			PAS. 6/210		
2	LINDJE			PAS. 6/210		
3	JUG			PAS. 6/522		
4	PERENDIM			PAS. 6/522 E 6/210		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: ING. GJEODET LESJAN DOSTI

LICENCA: NR. T.1139/3 DATE 28.03.2025

KOMPANIA: LESJAN DOSTI P.F

NIPT: L82067801R

NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI _____

DVASHK _____

NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI

Lesjan

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENSHKRIMI / VULA _____

Digitally signed by
Lesjan Dosti
Date: 2025.09.02
10:57:38 +02'00'

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:T-TERREN , G-GPS, D-MATJE DISTANCASH

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: _____

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI : SHTET

NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale